



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 381/1 Prot.

Tiranë, më 22.05.2018

### V E N D I M

**Nr.50, datë 22.05.2018**

**“MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË NISUR ME URDHRIN NR. 28, DATË 4.4.2017, “PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË GJATË PROCESIT TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL, NË BASHKINË TIRANË, PËR PERIUdhËN 01.09.2015, DERI NË 01.04.2017”.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 381 prot., datë 03.04.2018, dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë gjatë procesit të pranimit në shërbimin civil, të zhvilluar në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tiranë,

### VËREJ SE:

Nëpërmjet urdhrin nr. 28, datë 04.04.2017, “Për verifikimin e ligjshmërisë gjatë procesit të pranimit në shërbimin civil, në Bashkinë Tiranë, për periudhën 01.09.2015, deri në 01.04.2017”, është urdhëruar fillimi i mbikëqyrjes tematike pranë institucionit Bashkia Tiranë, me qëllim për të mundësuar verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë procesit të plotësimit të vendeve të lira të punës të cilat përfshihen në shërbimin civil.

Mbas verifikimit të dokumentacionit i cili materializon procedurat e ndjekura përplotësimin e vendeve të lira të punës të cilat përfshihen në shërbimit civil, për periudhën 01.09.2015, deri në 01.04.2017, është konstatuar se:

Institucioni i Bashkisë Tiranë funksionon mbi bazën e ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i cili në nenin 5 të tij e klasifikon këtë institucion si “njësi e qeverisjes vendore” dhe si i tillë, referuar nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të shërbimit civil.

Nga përmbajtja e nenit 64, pika “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, miratimi i strukturës, organikës dhe klasifikimi i kategorisë/klasave të pozicioneve të punës dhe pagat (duke përfshirë edhe pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil), janë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë. Kjo kompetencë, kufizohet vetëm sa ka të bëjë me përcaktimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, sepse sipas parashikimeve të nenit 54/dh, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Këshilli Bashkiak në vendimin për miratimin e buxhetit të institucionit, miraton gjithashtu, edhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të saj.

Gjatë periudhës së përfshirë në inspektim, të përcaktuar në urdhrin e Komisionerit (01.09.2015, deri në 01.04.2017), struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të Bashkisë Tiranë, kanë pësuar disa ndryshime të diktuar edhe nga ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Momentalisht, me vendimin nr.58, datë 30.12.2015, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016”, krahas miratimit të buxhetit është miratuar edhe numri maksimal i punonjësve të institucionit. Në mbështetje të këtij akti, Kryetari i Bashkisë Tiranë, me urdhrin nr. 4444, datë 01.02.2017, “Për një ndryshim të strukturës dhe organikës përfundimtare të institucionit të Bashkisë Tiranë”, ka miratuar strukturën organizative dhe organigramën në përbërje të cilës janë punësuar 1200 punonjës të cilët janë ndarë si më poshtë:

|  |     |
|--|-----|
| Punonjës të administratës së Bashkisë Tiranë-Qendër                  | 687 |
| Punonjës të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit                        | 4   |
| Punonjës të Gjendjes Civile  | 3   |
| Punonjës të administratës të Njësive Administrative, Bashkisë Tiranë | 506 |

Duke i klasifikuar pozicionet në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në këtë institucion, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, ndahen si më poshtë:

- ✓ **60 pozicione pune në kategorinë e mesme drejtuese**, të cilat ndahen në: 11 pozicione pune “Drejtor i Përgjithëm” dhe 49 pozicione pune “Drejtor Drejtorie”;
- ✓ **159 pozicione pune në kategorinë e ulët drejtuese**, ku bëjnë pjesë: 79 pozicione pune “Përgjegjës Sektori” pranë Bashkisë Qendër dhe 80 pozicione pune pranë 24 Njësive Administrative;

- ✓ **750 pozicione pune në kategorinë ekzekutive**, ku bëjnë pjesë: **485 pozicione pune “Specialist”** në administratën e Bashkisë Qendër dhe **265 pozicione pune**, në 24 Njësi Administrative;

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, gjatë periudhës së përfshirë në inspektim (01.09.2015, deri në 01.04.2017), për plotësimin e pozicioneve të punë pjesë e shërbimit civil, janë realizuar **458 emërimet** nëpërmjet procedurave të ndryshme të rekrutimit nga të cilat:

*Niveli i mesëm drejtues* - **1** lëvizje paralele dhe **40** ngritje në detyrë + hyrje në sh.c.

*Niveli i ulët drejtues* - **3** lëvizje paralele dhe **88** ngritje në detyrë + hyrje në shërbimin civil

*Niveli ekzekutiv* - **15** lëvizje paralele dhe **311** hyrje në shërbimin civil.

- ✓ *Respektimi i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e planit të rekrutimit për vitet 2015, 2016, 2017.*

Administrimi i shërbimit civil në bazë të planit vjetor të pranimit, është parashikuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar Vendimi nr. 108, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit. Këto dispozita përcaktojnë se organet e qeverisjes vendore në përgatitjen e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të kenë parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera.

Më tej, në pikat 11 dhe 13 të aktit nënligjor të përmendur më sipër, përcaktohet se *njësitë e qeverisjes vendore, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore të cilat publikohen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.*

Institucioni i Bashkisë Tiranë, gjatë procesit të plotësimit të vendeve të punës pjesë e shërbimit civil, përgjithësisht kishte respektuar këto kërkesa, çka provohet me vendimet e Kryetarit të Bashkisë nr. 19058/2, datë 26.11.2015, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, nr.143, datë 06.01.2016, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, nr.7024, datë 02.03.2016, “Për një shtesë në planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, nr. 6020, datë 13.02.2017, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil”, nëpërmjet të cilëve kanë planifikuar për çdo vit kalendarik nevojat e këtij institucioni për plotësimin e pozicioneve të lira të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Vetëm në një rast është konstatuar se është shkelur afati ligjor i përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi vendimi nr. 19058/2, datë

26.11.2015, “Për planin vjetor për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil” është miratuar në muajin nëntor, ndërkohë që sipas afatit të përcaktuar nga ligji, ky vendim duhet të merrej brenda muajit shkurt 2015, ç’ka rezulton të jetë rregulluar në vitet pasardhëse.

Me qëllim që të realizohet një proces normal rekrutimi, institucioni, duhet të kujdeset për të mundur në vijim, hartimin, miratimin dhe publikimin e planeve vjetore të pranimit në shërbimin civil, brenda afatit të përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në aktet ligjore që rregullojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

- ✓ *Respektimi i kërkesave ligjore lidhur me publikimin e njoftimeve për plotësimin e vendeve të lira të punës.*

Akti i shpalljes për plotësimin e një pozicioni të lirë pune në shërbimin civil, ka një rëndësi të veçantë për procesin. Ai duhet të konceptohet në mënyrë sa më të qartë, të përmbajë të dhëna të plota e të sqaruara me detaje të mjaftueshme në mënyrë që të informojë kandidatët për dokumentacionin që duhet të paraqesë, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave, vendin, kohën e datën që do të zhvillohet konkurrimi, etj. Gjithashtu dokumenti i shpalljes duhet të bëhet publik, në mënyrë që konkurrimet të bazohen në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe të kryhen nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Për të mbikëqyrur dokumentin e shpalljes, u verifikua fakti nëse shpallja është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, sipas përcaktimeve të pikës 6, Kreu II, e pikës 3, Kreu III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* si dhe të pikës 6, Kreut II, e pikës 3, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

Nga analiza e elementëve të dokumentit të shpalljes, rezultoi se, njësia përgjegjëse e institucionit Bashkia Tiranë, përpara zhvillimit të çdo konkurrimi është kujdesur për të publikuar njoftimin për fillimin e procedurave të plotësimit të vendeve të lira të punës, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës për secilin grup. Publikimi i tyre është realizuar nëpërmjet portalit *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*, dhe faqes në internet të institucionit. Nga përmbajtja e këtyre akteve, rezulton se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore që duhet të përmbajë një shpallje, kërkesa të përcaktuara në pikën 9, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”* dhe pikën 8, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*. Akti i njoftimit përmbante elementet dhe të dhënat e nevojshme, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;

mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

Një drejtim tjetër, ku u përqendrua inspektimi i kësaj faze të rekrutimit, është verifikimi nëse në dokumentin e shpalljes, janë përcaktuar kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët duhet të zotërojnë për të aplikuar në konkurrim, përveç kërkesave të përgjithshme, të cilat janë të specifikuar në mënyrë të shprehur, në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i dokumenteve të shpalljes së konkurremeve të mbikëqyrura, rezulton se në to janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme, kushtet specifike, si dhe kërkesat e veçanta, të cilat janë në përputhje me Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar.

- ✓ Respektimi i kërkesave ligjore lidhur me seleksionimin paraprak të kandidatëve, dhe publikimi i listës së konkurentëve të kualifikuar për testim.

Brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit (*afat i cili është përcaktuar në shpallje*), Njësia Përgjegjëse zhvillon fazën e verifikimit paraprak, e cila parashikon për zgjedhjen e “Kandidatëve të kualifikuar” për konkurim në lidhje me:

a) procedurën e lëvizjes paralele dhe më tej, pranimin në kategorinë ekzekutive, bazuar në pikën 4, neni 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në pikën 2, Kreu IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe,

b) procedurën e ngritjes në detyrë, bazuar në pikën 6, neni 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në pikën 22, Kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”.

Në këtë fazë, aplikantët i nënshtrohen verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar prej tyre, nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e specifike të përcaktuara në aktin e shpalljes dhe në aktin nënligjor që rregullon këtë aspekt. Verifikimi paraprak, është një proces që finalizohet me Listën Përfundimtare, e cila ka të bëjë me një procedurë riverifikimi të dosjeve të aplikantëve, që nuk janë kualifikuar, në rast të ankimit, brenda 5 ditëve nga shpallja në portal, e listës së kandidatëve të kualifikuar.

Konstatohet se, nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Tiranë, ky proces është realizuar dhe gjatë kësaj faze të konkurimit, është bërë në kohë publikimi i verifikimit paraprak dhe listës përfundimtare, në respektim të akteve ligjore që rregullojnë këtë aspekt. Me përfundimin e procedurës së mësipërme, rezulton se njësia përgjegjëse, në

çdo rast,i ka përcjellë Komisioneve Përzgjedhëse, listën e kandidatëve që do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimit.

U konstatua se, në dy raste, njësia përgjegjëse, ka gabuar në seleksionimin e kandidatëve. Bëhet fjalë për kandidatët **\*\*\*\*\***, për pozicionin “*specialiste në Zyrën e Informimit Qytetar*” pranë Njesisë Bashkiake nr.1 dhe **\*\*\*\*\***, për pozicionin “*specialiste finance*” pranë Njesisë Administrative Zallbatar, të cilat u kualifikuan në fazën e dytë të testimit, pra atë të “*ngritjes në detyrë*”, ndërkohë që duhet të kualifikoheshin që në fazën e parë, atë të “*lëvizjes paralele*”.

Më konkretisht, këto dy punonjëse efektivisht kanë qenë të punësuar pranë Bashkisë Tiranë në këto pozicione pune:

- **\*\*\*\*\***, me aktin nr. 546/1 prot., dt. 25.03.2002, është konfirmuar nëpunëse civile në pozicionin e punës “*specialiste e financës*” në Njësinë Bashkiake nr.1 Tiranë dhe me aktin nr. 1853/1 prot., dt. 15.03.2014, është deklaruar statusi i punësimit nëpunës civil në pozicionin e punës “*llogaritare/arkëtare*” po pranë kësaj njësie. Më pas, në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit, me urdhrin nr. 4414/1 prot., datë 29.02.2016, është liruar nga puna.
- **\*\*\*\*\***, sipas librezës së punës dhe vërtetimit nr.1305 prot., datë 14.10.2016, të Njesisë Administrative Zall-Bastar, është punësuar pranë këtij institucioni, në datën 1.6.1993, në pozicionin e punës “*arkiviste dhe inspektore në financë*”. Nga data 1.1.1995 deri në datën 31.5.2005, ka punuar si inspektore finance dhe në datën 1.9.2005 është ngritur në detyrë duke u emëruar “*përgjegjëse e zyrën së ndihmës ekonomike*”. Hyrja në fuqi e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, e ka gjeturkëtë nëpunësenë pozicionin e “inspektore së Tatim Taksave, pozicion të cilin e mbante nga data 1.6.2011. Duke qenë se, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji (26.2.2014), punonjësja **\*\*\*\*\***, mbante për më shumë se një vit, një pozicion pune,pjesë e shërbimit civil, referuar nenit 67, pika 3, kjo punonjëse duhet të deklarohet në kategorinë nëpunëse civile. Në dosjen personale të saj nuk është administruar akti i deklarimit të statusit të punësimit.Për arsye tëristrukturimit të institucionit, si pasoje e ndryshimeve ligjore që rregullonin veprimtarine e tij, në datën 30.4.2016, është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe pa kaluar 8 muaj nga lirimi, ajo është shpallurfituese në konkursin e realizuar për plotësimin e pozicionit të punës “*specialist finance në sektorin e shërbimeve mbështetëse*”, në Njësinë Administrative Zall-Bastar.Me aktin nr. 2309 prot., datë19.01.2017, është përmbyllur kjo procedurë, duke u emëruar Mejte Koçi “*nëpunëse civile në periudhë prove*”,në pozicionin si më sipër.

Sa më sipër, **\*\*\*\*\*** dhe **\*\*\*\*\***, referuar nenit 50, pika 8/a, të ligjit nr. 152/2015 “*Për nëpunësit civil*”, i ndryshuar, i cili sanksionon se:

“Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;

b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil”;

në momentin e zhvillimit të procedurës së konkurrimit, duke qenë se ishin liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit, gëzonin të drejtën të konkurronin me cilësinë e nëpunësit civil në procedurat e lëvizjes paralele dhe jo në atë të ngritjes në detyrë, pasi për to, ende nuk kishte përfunduar afati dy vjeçar pas lirimit nga detyra.

Kjo e drejtë e nëpunëseve në fjalë, është shkelur në momentin e seleksionimit të kandidatëve gjatë fazës së parë të konkurimit, atë të “lëvizjes paralele”, fazë e cila ka përfunduar pa ndonjë kandidat të kualifikuar.

Duke qenë se këto punonjëse janë kualifikuar të konkurojnë në fazën e dytë, atë të “pranimit në shërbimin civil”, në përfundim të kësaj procedure, janë emëruar “nëpunës civil në periudhë prove”, ndërkohë që në rast se do të kualifikoheshin që në fazën e parë, do të emëroheshin “nëpunës civil” në pozicionin për të cilin kishin konkuruar.

Me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, referuar nenit 113, të ligji 44/2015, “Kodi i Procedurave të Republikës së Shqipërisë”, Njësia Përgjegjëse duhet të shfuqizojë pjesërisht aktet e emërimit të nëpunëseve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , duke i emëruar këto nëpunëse sipas statusit të fituar me herët “nëpunës civil”.

✓ Procedura e ndjekur në lidhje me krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komitetit të Vlerësimit.

Gjatë kontrollit të ushtruar rezultoi se, në zbatim të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 152/2015, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8, të nenit 19, të këtij ligji, është konstatuar se pranë institucionit Bashkia Tiranë, është krijuar ky mekanizëm. Gjithashtu rezulton se janë respektuar edhe rregullat e hollësishme që parashikohen në Kreun 3, “Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv”, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, pasi në çdo procedurë është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit.

Nga ana tjetër, në lidhje me ngritjen e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP) dhe Komitetin e Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), vërehet se për **11** pozicionet e punës “*drejtor i përgjithshëm*”, nuk janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore.

Në të dyja fazat e konkurimit, në përbërje të Komiteteve të Pranimit, referuar pikës 16/b, kreu II, dhe pikës 7/c, kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese*”, duhet të jetë dhe një anëtar i cili merr pjesë në këtë mekanizëm me cilësinë e “eprorit direkt” të pozicionit të punës për të cilën po kryhen procedurat e rekrutimit.

Nga verifikimi i akteve të krijimit të këtyre strukturave, u konstata se në plotësimin e pozicioneve të punës “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në përbërje të tyre, nuk ishte caktuar “*eprori direkt*”, kjo për faktin se, në këtë institucion nuk ekziston niveli i lartë drejtues. Mungesa e kësaj kategorie, sjell një sërë problemesh në skemën e administrimit të shërbimit civil, që prekin disa institute të ligjit.

Më konkretisht, administrata e Bashkisë Tiranë është e organizuar me **11** “*drejtori të përgjithshme*” dhe **49** “*drejtori*”, të cilët janë në të njëjtën kategori, atë të “*nivelit të mesëm drejtues*”. Struktura dhe organika e institucionit nuk ka parashikuar ndonjë pozicion të shërbimit civil të nivelit të lartë drejtues të “*sekretarit të përgjithshëm*”, apo pozicione të barasvlefshëm me të, ashtu siç është analizuar edhe në udhëzimin e Komisionerit, dërguar Bashkisë Tiranë, në lidhje me funksionimin e skemës së administrimit në shërbimin civil. Ky fakt krijon vështirësi në zbatimin e disa skemave të administrimit të shërbimit civil të tilla si:

- *Ngritja e komisionit disiplinor*, në rastin kur ndaj një nëpunësi civil fillon procedim disiplinor për shkelje disiplinore të rënda ose shumë të rënda, sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe pikës 3 të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”.
- *Miratimi i përshkrimeve të punës*, i parashikuar në pikën 18 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, ndryshuar. Në shkronjën “ç” të kësaj pike është parashikuar se: “*përshkrimet e punës miratohen nga sekretari i përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent me të, për njësitë e qeverisjes vendore*”.
- *Sistemi i vlerësimit të rezultateve të punës*, i parashikuar nga Vendimi nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar me VKM nr. 252, datë 30.3.2016.
- *Ngritjen e Komiteteve të Pranimit*, parashikuar nga pika 16/b, kreu II, dhe pika 7/c, kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese*”.



Për të siguruar zbatimin e parimeve të administrimit në shërbimit civil, Bashkia Tiranë, gjatë hartimit të strukturëspasardhëse të institucionit, duhet të ketë në vëmendje përcaktimet ligjore të Vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshilli të Ministrave, *“Për grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”* në ldhjen nr.1. Struktura aktuale, përbëhet nga disa kategori të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar. Më konkretisht në këtë institucion ekzistojnë kategoritë e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive, të cilave i përgjigjen klasat *“Drejtor i Përgjithshëm”* (i cili në përputhje me pagën e pozicionit është klasifikuar si pozicion i nivelit të mesëm drejtues. Emërtimi Drejtor i Përgjithshëm në këtë rast, është për të përcaktuar hierarkinë administrative në kuptim të realizimit të detyrave funksionale), *“Drejtor Drejtorie”*, *“Përgjegjës Sektori”* dhe *“Specialist/inspektor”*.

Nga përmbajtja e aktit nënligjor të përmendur më sipër, rezulton se, në varësi të numrit të banorëve të njësisë vendore, është sanksionuar edhe struktura organizative e institucioneve të qeverisjes vendore, duke përfshirë në të edhe pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të ndara në kategori dhe klasa.

Duke analizuar parimin e hierarkisë administrative, kategorisë së lartë drejtuese, i përgjigjen pozicionet e punës *“Drejtor i Përgjithshëm”* dhe *“Sekretar i Përgjithshëm”*, të cilët janë pozicionet më të larta në menaxhimin e shërbimit civil. Këto pozicione përgjigjen për formulimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre; përcaktojnë objektivat dhe formulojnë programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatimin e tyre, sigurojnë përdorimin eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe objektivave, planifikojnë dhe drejojnë veprimtarinë e përditshme administrative të institucionit.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh kompetencën që ka Kryetari i Bashkisë për miratimin e strukturës së institucionit, për vitin në vijim, njësia përgjegjëse, në zbatim të detyrave të ngarkuara prej ligjit për nëpunësin civil, duhet të paraqesë një relacion sqarues për të evidentuar detyrimin ligjor që ka bashkia për të respektuar skemën e funksionimit të shërbimit civil.

Me qëllim që kjo strukturë të jetë efikase dhe e mbështetur në ligj, gjatë punës për hartimin e saj, njësia përgjegjëse duhet të orientohet nga parashikimet e ligjit nr. 90/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, si dhe në vendim nr. 893, datë 17.12.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, ku përcaktohen parimet e ndërtimit të administratës, ndër të tjera parimi i unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficientësisë dhe efektivitetit.

Sjellim në vëmendjen tuaj këtë akt nënligjor, i cili ka vendosur standarde të reja në këtë fushë, pasi ai mund të shërbejë si një moment për të ndihmuar të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, duke përfshirë këtu edhe institucionet e pavarura dhe ato të administratës vendore, për të ndërtuar struktura mbi baza shkencore që funksionojnë, të cilat janë afatgjata dhe i përgjigjen kërkesave të kohës.

Të gjitha sa analizuam më sipër lidhur me strukturën e institucionit, do të ndihmonin përtë mundësia efikasitet në veprimtarinë e burimeve njerëzore të institucionit dhe një administrimin më të mirë të shërbimit civil, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta për të gjitha institutet e tij.

Nga ana tjetër, është konstatuar se Komitetet e Pranimit, kanë ndjekur të gjitha hapat e përcaktuara nga aktet ligjore lidhur me vlerësimin e kandidatëve. I gjithë procesi i testimit dhe vlerësimit të kandidatëve gjatë procedurës së konkurrimit, është materializuar me akte shkresore të cilat provojnë realizimin në kohë të hapave të ndjekura gjatë këtij procesi. Për çdo rekrutim është aplikuar fillimisht procedura për lëvizje paralele dhe në rast të mosplotësimit të vendit të lirë është vijuar më tej, me procedurën e ngritjes në detyrë.

*Respektimi i kërkesave ligjore në procesin e vlerësimit të kandidatëve nga Komiteti i Pranimit, në procesin e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.*

Në lidhje me procesin e vlerësimit të kandidatëve nga ana e Komitetit të Pranimit, sipas akteve që materializojnë këtë proces, është konstatuar se në të gjitha rastet është vendosur me unanimitet dhe proceset e vlerësimit nuk janë kontestuar nga kandidatët. Njësia Përgjegjëse është kujdesur në respektimin e afteve procedurale për kalimin nga njëra fazë e konkurrimit tek tjetra dhe në përfundim të çdo procedure konkurrimi, është realizuar shpallja e fituesit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në faqen e internetit të institucionit. Në tabelën “I” bashkëlidhur këtij relacioni janë hedhur të dhënat e akteve administrative nëpërmjet të cilave pasqyrohet hollësisht respektimi i kërkesave ligjore në procesin e plotësimit të vendeve të lira të punës pjesë e shërbimit civil.

✓ *Emërimi dhe konfirmimi i kandidatëve fitues në shërbimin civil*

Një rëndësi të veçantë ka edhe finalizimi i procesit të konkurrimit, i cili konsiston në emërimin e kandidatit fitues në pozicionin e punës për të cilin ka konkurruar.

Referuar nenit 23 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, kandidatët fitues, të përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 22, të këtij ligji, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të zgjedhin të emërohen në çdo pozicion të grupit, për të cilin është zhvilluar konkurrimi, si dhe në çdo pozicion tjetër të lirë të të njëjtit grup, në nivelin ekzekutiv, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës. Menjëherëpas marrjes së miratimit zyrtar nga kandidati fitues, Njësia Përgjegjëse, ka detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 2 të po kësaj dispozite, të nxjerr aktin e emërimit.

Gjatë periudhës së verifikuar, në përfundim të çdo konkurrimi, nga ana e Njësisë Përgjegjëse janë hartuar aktet e emërimit në detyrë dhe aktet e fillimit të marrëdhënieve financiare për çdo kandidat fitues i cili kishte shprehur më parë dakortësinë për pozicionin e ofruar. Në përfundim të periudhës së provës, pas ndjekjes së programit të detyrueshëm dhe marrjes së rezultatit kalues të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s, udhëzimeve të nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ishin vendosur, dhe vlerësimit të rezultateve individuale në punë i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore, është realizuar konfirmimi i tyre si “*nëpunës civil*”.

Mbaskëqyrjes së akteve të emërimit, është konstatuar se të gjithë nëpunësit civil të emëruar gjatë periudhës 01.09.2015, deri në 01.04.2017, të rekrutuar nga jashtë shërbimit civil, pavarësisht pozicionit të punës, janë emëruar “nëpunës civil në periudhë prove”.

Ligji nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar si dhe Vendimi nr. 243, datë 18.03.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, sanksionojnë se periudha e provës është e detyrueshme vetëm në rastet e emërimit në kategorinë ekzekutive, kjo për faktin se hyrjet nga jashtë në shërbimin civil lejohen në këtë kategori. Në kreun 6, të aktit nënligjor të sipërcituar, parashikohet se nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Punonjësi i emëruar për herë të parë në shërbimin civil nuk ka përvojë dhe për këtë arsye gjatë vitit të parë të punës duhet të mbikëqyret gjatë kryerjes së detyrave nga një nëpunës civil me përvojë.

Ndërsa, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, realizohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe në rast të mosplotësimit të tyre vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë. Në raste të veçanta, organi kompetent, mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për këto kategori të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira, por në çdo rast, nuk mund të kalojë 20 % të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezultoi se, në institucionin e Bashkisë Tiranë, nuk është kuptuar drejtëkjo kërkesë e ligjit, pasi janë rekrutuar në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese punonjës nga jashtë shërbimit civil, duke tejkaluar kufirin 20% të sanksionuar nga pika 4, e nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse, në të ardhmen duhet të tregojë kujdes në përcaktimin e kriterëve të pranimit për këto kategori (*e ulët dhe e mesme drejtuese*), pasi vetëm në raste specifike, duhet të lejohet pjesëmarrja në konkurrim e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil me qëllim që të mundësohet zbatimi i sistemit të karrierës në shërbimin civil. Në kriteret e pranimit të justifikohet arsyeja që për këtë pozicion pune mund të konkurrojnë kandidatë nga jashtë shërbimit civil, pra të shpjegohet domosdoshmëria e zgjerimit të mundësisë për përzgjedhje e kandidatëve. Gjithashtu, kjo procedurë duhet të evidentohet në planin e rekrutimit, duke parashikuar pozicionet që mund të plotësohen në këtë mënyrë.

Gjatë inspektimit është konstatuar se, nëpunësit e rekrutuar nga jashtë shërbimit civil në kategoritë e ulët dhe të mesme drejtuese, janë emëruar “nëpunës civil në periudhë prove”. Këto emërimë bien ndesh me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi në këtë ligj për këto kategori nuk parashikohet periudha e provës. Në rast se, në një procedurë konkurrimi për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, rezulton fitues një kandidat i cili nuk vjen nga shërbimi civil, atëherë ai për shkak të ligjit duhet të emërohet “nëpunës civil”, kjo për faktin se ka rezultuar fitues në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, në të cilën nuk ka parashikuar periudhë prove.

Referuar pikës 40 të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, në të cilit sanksionohet se:

*“Nëpunësi civil i emëruar nuk i nënshtrohet periudhës së provës”*,

Njësia përgjegjëse, pas marrjes së mendimit zyrtar nga kandidati fitues, nxjerr aktin e emërimit në pozicionin për të cilin ka kandiduar, duke saktësuar statusin e tij të punësimit si “nëpunës civil”.

Në këto kushte, Njësia Përgjegjëse duhet të tregojë kujdes në përpilimin e aktit të emërimit në pozicione pune të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, pasi çdo kandidat i cili rezulton fitues në këto pozicione pune, emërohet për shkak të ligjit si “nëpunës civil”.

Mirëpo, për të rregulluar situatën ligjore, aktualisht nuk mund të veprohet pasi këta nëpunës e kanë përfunduar periudhën e provës dhe aktualisht janë konfirmuar “nëpunës civil”. Njësia Përgjegjëse e institucionit, të tregojë kujdes në të ardhmen lidhur me aktet e emërimit të kandidatëve fitues të rekrutuar nga jashtë shërbimit civil në pozicionet e punës të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, duke i emëruar këta punonjës “nëpunës civil” dhe të marrë masa vetëm për trajnimin e tyre pranë ASPA.

### iii. Konstatime të tjera:

Në përfundim të këtij hetimi administrativ është konstatuar se, nga ana e institucionit Bashkia Tiranë, përgjithësisht ishin marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës duke respektuar procedurat e përcaktuara nga ligji. Nga Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni, ishte punuar shumë dhe me seriozitet lidhur me zhvillimin e procedurave të konkurrimit, hedhjen në sistem të të dhënave, administrimin e listës së pritjes për kandidatët të cilët kishin rezultuar kalues në konkurrim, trajnimin në kohë të personelit dhe administrimin e dosjeve personale të tyre, pasi janë zhvilluar një numër relativisht i lartë konkurrimesh në raport me periudhën kohore të inspektuar. Nga ana tjetër, pavarësisht këtyre fakteve, janë konstatuar edhe disa parregullsi të cilat po i trajtojmë më poshtë:

#### 1. Emërimë me kontratë, apo akt emërimi të thjeshtë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Nga krahasimi i bërë strukturës organike dhe listëpagesës së muajit shtatorit 2015 me strukturën organike dhe listëpagesën e muajit marsit 2017, rezultoi se gjatë periudhës së inspektimit, në institucionin e Bashkisë Tiranë, ishin emëruar punonjës me kontratë, apo akt emërimi të përkohshëm në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Për periudhën që po analizojmë, në strukturën e institucionit, si në Aparatin e Bashkisë Tiranë ashtu edhe në 24 Njësitë Administrative, ekzistojnë 24 pozicione pune “*arkivist-protokoll*”, plotësimi i të cilëve është bërë përmes një akti të thjeshtë emërimi, kjo për faktin se ky pozicion pune nuk është konsideruar nga institucioni pjesë e shërbimit civil.

Për të përcaktuar nëse këto pozicione pune përfshihen ose jo në fushën e veprimit të shërbimit civil, duhet të analizohet se si e përcaktojnë aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë veprimtarinë e pozicioneve në fjalë, duke analizuar hollësisht karakteristikat e tyre, të përbashkëtat dhe veçantitë në raport me pozicionet e tjera të kategorisë ekzekutive, pjesë e shërbimit civil, të përcaktuara qartësisht në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave. “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”. Më konkretisht, në pikën 9 të këtij akti nënligjor, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, të ndara sipas natyrës së pozicionit në:

- a) grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm; dhe
- b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm

Në pikën 12 të tij, përcaktohet se grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në Lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi. Më tej, Lidhja nr. 3 “*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*”, në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse. Në këtë renditje, rezulton se në nëngrupin që i përket ndarjes me numër rendor 26, përcaktohet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës “*arkivistë, librarë, bibliotekarë dhe përgjegjës në këto fusha*”, si pozicione që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil. Për këto pozicione pune kërkohet arsim i lartë sipas specifikës së përshkrimit të punës, për arkivist si dhe në shkencat shoqërore që lidhen me arkivat. Gjithashtu, në nenin 2/1 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “*Për arkivat*”, përcaktohet se: “*Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre*”.

Siç shpjeguar më sipër, duke qenë se “*arkivë*” konsiderohen edhe njësitë strukturore të ngritura pranë njësive vendore (në rastin konkret Bashkia Tiranë), pozicioni i punës “*arkivist*” është klasifikuar në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm, e konkretisht me numër rendor 26, në lidhjen nr. 3.

Në nenin 2/1, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, përcaktohen qartë se cilat janë detyrat që duhet të kryejë një nëpunës arkive. Nisur nga këto detyra, grupi i punës konstatoi se punonjësit të cilët ishin emëruar “arkivist” pranë njësive administrative të Bashkisë Tiranë nuk kryenin detyrat e përcaktuara nga kjo normë ligjore. Puna e tyre konsistonte vetëm në marrjen e dokumentave dhe delegimin e tyre pranë aparatit të Bashkisë qendër dhe i gjithë dokumentacioni i ardhur evidentohet, ruhet dhe përpunohej nga punonjësit e “arkiv/protokollit” të aparatit të Bashkisë qendër. Për këtë arsye, vetëm punonjësit e aparatit të Bashkisë qendër, të cilët janë ngarkuar të kryejnë këto detyra, duhet të emërohen sipas mënyrës së parashikuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi pozicioni i punës “arkivist” për shkak të akteve ligjore të sipërcituara përfshihet në shërbimin civil. Nga verifikimi rezultoi se vetëm në një rast, rekrutimi në këtë pozicion pune është bërë në mënyrë të kundraligjshme. Bëhet fjalë për:

- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*specialist në Drejtorinë e Arkivit Qendror dhe Protokollit*”, emëruar me kontratën individuale të punës nr. 18741/16, datë 19.11.2015.

Për të rregulluar situatën ligjore, institucioni duhet të ndryshojë klasifikimin e këtij pozicioni pune në strukturën e tij duke e konsideruar pjesë të shërbimit civil për këtë rast. Njësia Përgjegjëse e institucionit duhet të marrë masa për plotësimin e këtij pozicioni punenëpërmjet procedurave të konkurrimit, duke u kujdesur të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Nga aktet shkresore të administruara, rezulton se janë emëruar në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, edhe punonjësit:

- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Burimeve Njerëzore, rekrutimit dhe procedurave*”, emëruar me kontratën individuale të punës nr. 18741/3, datë 19.11.2015 dhe
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*specialist i emergjencave civile*”, Njësia Administrative Bërzhitë, emëruar me kontratën individuale të punës nr. 14100, datë 10.05.2016.

Nga ana e institucionit, me të drejtë këto dy pozicione pune janë trajtuar si pozicione që përfshihen në shërbimin civil, pasi nëpunësit të cilët punonin në njësitë e tjera administrative të barazvlefshme me to janë rekrutuar dhe më pas trajtuar si nëpunës civil. Emërimet e analizuara më sipër janë kryer duke mos respektuar procedurën për plotësimin e vendeve të lira të punës, sipas neneve 20 e vijuese, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Emërimet e punonjësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, nuk janë realizuar sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë e plotësimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, por janë realizuar përmes një akti administrativ të nxjerrë nga një organ i cili nuk kishte kompetencë ligjore. Shkelja e procedurës dhe mungesa e kompetencës ligjore të organit i cili ka nxjerrë aktet e emërimit, sipas germës “a”, pikat “i” e “ii” dhe germës “ç”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i bën këto akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Tiranë, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, Njësia Përgjegjëse, menjëherë të fillojë procedurat për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### 3. Standartizimi ligjor i emërimeve për disa pozicione pune.

Në strukturën e këtij institucioni janë parashikuar dy pozicione pune “specialist në sektorin e informimit dhe shërbimit të qytetarit”, në Drejtorinë e Komunikimit me Qytetarin, plotësimi i të cilëve është bërë nëpërmjet një kontrate pune, duke zbatuar si bazë ligjore Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.

Bëhet fjalë për emërimin e punonjësve:

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “specialist” në sektorin e informimit dhe shërbimit me qytetarin”, emëruar me kontratën individuale të punës nr. 19609, datë 23.06.2016.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “specialist” në sektorin e informimit dhe shërbimit me qytetarin”, Drejtoria e Komunikimit me Qytetarin, emëruar me kontratën individuale të punës nr. 19608, datë 23.06.2016.

Për të përcaktuar nëse këto pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, është analizuar pozicionimin e vendeve të punës në strukturën organizative pranë drejtorive apo sektorëve përkatës, detyrat dhe përgjegjësitë që realizon çdo pozicion pune, si dhe kërkesat për nivelin e edukimit arsimor për kryerjen e detyrave. Duke vlerësuar përshkrimin e pozicionit të punës, vërehet se detyrat që i ngarkohen nëpunësve janë të natyrës bazike, për realizimin e të cilave nuk kërkohen njohuri të thelluara profesionale, qoftë si aftësi analitike, ashtu edhe në drejtim të planifikimit të pavarur, pasi nuk kanë karakter menaxhues apo kontrollues. Këto pozicione pune nuk shërbejnë për të zgjidhur problemet e hasura brenda procedurave teknike/administrative të përcaktuara, apo politikave të institucionit. Puna e “specialistit” në

këto pozicione është thjesht shërbimi ndaj qytetarit, pasi ka të bëjë me pritjen dhe informimin e etj.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, kemi të bëjmë me një cilësim të gabuar të pozicionit të punës, duke e emërtuar si pozicion të shërbimit civil e për këtë arsye, nga ana e institucionit duhet të ndryshojë emërtimi i pozicionit nga “specialist”, në “punonjës”.

Në strukturën e institucionit, vërehen disa pozicione pune pranë njësive administrative, të cilat përfshihen në shërbimin civil, me emërtimin “Përgjegjës Zyre”, kategori e cila nuk parashikohet në klasifikimin e pozicioneve të punës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Duke qenë se, pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, duhet të jenë të emëruara dhe klasifikuara sipas përcaktimeve të këtij akti nënligjor, që në momentin e miratimit të tyre në strukturën e institucionit, emërtesa e këtyre pozicioneve duhet të ndryshojë në përputhje me ligjin.

Për këtë arsye, Njësia Përgjegjëse, e cila menaxhon nëpunësit civilë të institucionit, në përmbajtjen e materialit propozues për strukturën dhe organikën e re, të arsyetojë në mënyrë të hollësishme pozicionimin e këtyre pozicioneve në strukturë, natyrën e punës, llojin e detyrave që ai realizon si dhe niveli arsimor i nevojshëm për kryerjen e detyrave e për pasojë të përcaktojë edhe emërtesën ligjore.

Njësia përgjegjëse duhet të vlerësojë për secilin pozicion pune, nëse ai realizon funksione apo detyra në përputhje me përcaktimet e shkronjës “c”, të nenit 4 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Nëpunës civil” është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizmit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre”.*

Në rast se, pozicioni i punës do të konsiderohet pjesë e shërbimit civil edhe emërtesa e tij duhet të jetë në përputhje me kategorizimin e pozicionit të punës në shërbimin civil që përcaktohen nga aktet ligjore përkatëse. Në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, i cili përcakton se cilat janë pozicionet e punës të cilat përfshihen në shërbimin civil, nuk parashikohet në ndonjë klasë apo kategori, pozicioni i punës me emërtesën “Përgjegjës Zyre”. Procedura për të emërtuar një pozicion pune, fillon me vlerësimin e tij, duke u nisur nga rëndësia që ka ky pozicion në shërbimin civil, vlerësim i cili realizohet duke u bazuar në përshkrimin e punës, në të cilin janë detajuar funksionet dhe detyrat. Më tej, vijohet me klasifikimin, duke ndjekur hap pas hapi metodologjinë e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, të përcaktuar në aktin nënligjor të sipërcituar.



Në përfundim të kontrollit të ushtruar pranë institucionit të vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tiranë, pas analizimit tëhollësishëm të dokumentacionit të nevojshëm dhe evidentimit të fakteve të sipërshënuara, Komisioneri përfundoi hetimin administrativ,

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Njësia Përgjegjëse, të respektojë kërkesat e nenit 9 të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të bëhet funksionale skema e administrimit të shërbimit civil. Me këtë synim, në materialin propozues për Këshillin Bashkiak, lidhur me miratimin e strukturës dhe organikës së re të institucionit, të arsyetojë në mënyrë të hollësishme domosdoshmërinë e disa ndryshimeve në strukturë që kanë të bëjnë me:
  - ✓ Krijimin e kategorisë “niveli i lartë drejtues” në strukturën e institucionit, siç është pozicioni “sekretar i përgjithshëm” apo një pozicion i barasvlefshëm me të, ndër të cilët Drejtor i Përgjithshëm, me detyra dhe kategori page që i përkasin këtij pozicioni, në kuptim të nenit 19, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
  - ✓ Të rregullohen emërtesat e pozicioneve të punës si më poshtë:
    - Për pozicionet e punës “*Specialist në sektorin e informimit dhe shërbimit me qytetarin*” në Drejtorinë e Komunikimit me Qytetarin, duke qenë se nuk përfshihet në shërbimin civil, të ndryshohet emërtesa në përputhje me detyrën që kryen realisht.
    - Për pozicionet e punës me emërtesën “*Përgjegjës Zyre*”, pranë Njësive Administrative, të realizohet ekuivalentimi (*njehsimi*) i tyre me emërtesat e pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 6, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut II, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
2. Kryetari i Bashkisë Tiranë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative si më poshtë:

- ✓ Kontratë individuale e punës nr. 18741/3, datë 19.11.2015, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Burimeve Njerëzore*”.
- ✓ Kontratë individuale e punës nr. 14100, datë 10.05.2016 për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist i emergjencave civile*”, Njësia Administrative Bërzhitë.
- ✓ Kontratë individuale e punës nr. 18741/16, datë 19.11.2015, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Arkivit Qendror dhe Protokollit*”,

dhe të rregullojë pasojat e ardhura nga këto akte duke ndërprerë marrëdhëniet e punës me këta punonjës, si dhe të urdhërojë menjëherë fillimin e procedurave për plotësimin e këtyre pozicioneve sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- Njësia Përgjegjëse e institucionit të shpallë si të lira dhe të plotësojë këto pozicione pune përmes procedurave të konkurrimit, duke u kujdesur të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV, “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
3. Njësia Përgjegjëse të shfuqizojë pjesërisht aktin administrativ nr. 2309 prot., datë 19.01.2017, duke emëruar punonjësën \*\*\*\*\*, “*nëpunëse civile*”, në pozicionin e punës “*specialiste finance*”, pranë Njesisë Administrative Zallbazar.
  4. Njësia Përgjegjëse të shfuqizojë pjesërisht aktin administrativ nr. 25115 prot., datë 16.08.2016, duke emëruar punonjësën \*\*\*\*\*, “*nëpunëse civile*”, në pozicionin e punës “*specialiste në Zyrën e Informimit Qytetar*”, pranë Njesisë Bashkiake nr.1.
  5. Bashkia Tiranë, të respektojë afatin e hartimit dhe miratimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, i cili duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.
  6. Të respektohen kërkesat e nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, lidhur me kufirin ligjor të rekrutimit nga jashtë shërbimit civil në procesin e plotësimit të pozicioneve të punës në kategoritë e “*ulët drejtuese*” dhe të “*mesme drejtuese*”. Plotësimi i këtyre pozicioneve duhet të realizohet nga radhët e nëpunësve civilë dhe në raste të veçanta dhe për arsye të justifikuara, mund të lejohet rekrutimi nga jashtë shërbimit civil, por gjithmonë të mos kalohet 20% e numrit total të vendeve për çdo vit kalendarik. Në të njëjtin akt, ku do të vendoset aplikimii këtij rasti

përfundimor, të përcaktohen edhe pozicionet e punës që do të plotësohen në këtë mënyrë.

7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tiranë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesë të gjitha aktet administrative që vërtetojnë realizimin e detyrave të ngarkuara.
9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**